



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 03/L-110**

**PËR NDËRPRERJEN E SHTATZËNËSISË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

**LIGJ PËR NDËRPRERJEN E SHTATZËNËSISË**

**KREU I**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi i ligjit**

Ky ligj vendos bazën ligjore për rregullimin e ndërprerjes së shtatzënësise. Qëllimi i vendimit për lejimin e ligjit për ndërprerjen e shtatzënise bëhet për shkaqe informative, shëndetësore dhe të largimit të rrezikshmërisë së jetës.

Si qëllim tjetër është marrja e të gjitha masave mbrojtjes për të larguar femrën nga rreziku i rritjes së morbiditetit dhe mortalitetit të saj si pasojë e bërjes së aborteve ilegale. Sigurimi i jetës së femrës në rrugë institucionale duke larguar nga format më të vrazhda dhe jo mjekësore jashtë institucionale që kanë sjellë edhe vdekjen.

## **Neni 2**

### **Përkufizimet**

Për qëllimet e këtij Ligji vlejné përkufizimet e termeve nga Ligji për shëndetësi Nr. 2004/4, Kapitulli I, neni 1 dhe përkufizimet e veçanta si vijon:

„**Gamete**” është qeliza seksuale që përcakton seksin (qeliza veze dhe spermatozoidi).

„**Zigota**” është bashkim i qelizës mashkullore dhe qelizës veze.

„**Fekondimi**” është faza më e hershme pas depërtimit të spermatozoidit në qelizën vezë.

„**Embrioni**” është organizëm i gjallë nga çasti i fekondimit deri në muajin e tretë të shtatzënisë.

„**Abort**” është ndërprerje e shtatzënisë me dhunë.

„**Fetusi**” është fryti prej javës së dhjetë (10) të shtatzënisë gjer në lindje.

„**Ndërprerja elektive e shtatzënisë**” është ndërprerja e shtatzënisë me qëllim dhe me dëshirën e femrës, pa arsye mjekësore.

„**Ndërprerja e indukuar shtatzënisë**” është ndërprerja e shtatzënisë me qëllim gjer në fund të javës së njëzetedytë (22) të shtatzënisë apo peshën e frytit deri në pesëqind (500) g.

„**Lindja e induktuar**” është dalja apo nxjerrja e frytit pas javës së njëzetedytë (22) të shtatzënisë nën ndikimin e barërave apo me ndërhyrje kirurgjike.

„**Lindje me fryt të vdekur**” është dalja apo nxjerrja e frytit të vdekur pas javës së njëzetedytë (22) të shtatzënisë apo me peshën e frytit mbi pesëqind (500) g.

„**Planifikimi i familjes**” është e drejta e individëve dhe çifteve që të informuar të parashohin dhe vendosin lirshëm mbi numrin, shpeshësinë dhe kohën në të cilën ata duan të kenë fëmijë.

„**Kontracepcioni**” janë metodat dhe mjetet që përdoren për pengimin e mbarësimit të qelizës vezë dhe zhvillimin e shtatzënisë.

## **KREU II**

### **E DREJTA NË JETË DHE TË DREJTAT E FEMRËS**

#### **Neni 3**

Ky Ligj garanton respektimin e jetës që nga zhvillimi i fetusit. Ky parim mund të shkelet vetëm në rastet e parapara me këtë ligj.

#### **Neni 4**

1. Çdo femër ka të drejtë të vendosë lirshëm mbi ndërprerjen e shtatzënisë sipas kriterëve të përcaktuara me këtë ligj.
2. Çdo femër ka të drejtën e këshillimit dhe informimit lidhur me ndërprerjen e shtatzënisë.
3. Femra e cila është e aftë sipas ligjit nuk i nënshtrohet ndërprerjes së shtatzënisë pa pëlqimin e saj.
4. Në rastet kur femra nuk ka aftësi veprimi ose kur kjo aftësi është e kufizuar, vendimi merret konform neneve 6, 10, 11.2, 12.1, 12.2 dhe 13 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor nëse ky ligj nuk parasheh ndryshe.

#### **Neni 5**

1. Çdo femër e moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç ka të drejtë që të kërkoj ndërprerjen elektive të shtatzënisë.
2. Femrat që kanë arritur moshën e rritur prej gjashtëmbëdhjetë (16) vjetësh dhe kanë marrë pëlqimin e prindit ose të kujdestarit ligjor kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen e shtatzënisë.
3. Femrat shtatzëne nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni janë të obliguara që së paku tri (3) ditë para ndërprerjes elektive të këshillohen nga specialisti përkatës.

#### **Neni 6**

Ndërprerja elektive e shtatzënisë mund të bëhet deri në fund të javës së dhjetë (10) të shtatzënisë duke llogaritur nga dita e parë e ciklit të fundit menstrual.

## **Neni 7**

Çdo ndërprerje e shtatzënisë pas javës së dhjetë (10) është në kundërshtim me ligjin e shëndetësisë dhe duhet të bëhet me komision shëndetësor profesional.

## **KREU III**

### **SHËRBIMET SHËNDETËSORE**

## **Neni 8**

1. Mjeku familjar ose specialisti gjinekolog - obstetër, që në vizitën e parë obligohet që të informojë, këshilloj dhe udhëzoj shtatzënë e cila kërkon ndërprerjen elektive të shtatzënisë për:

- 1.1. rreziqet mjekësore dhe emocionale që sjell ndërprerja e shtatzënisë për shëndetin e femrës.
- 1.2. të drejtat, ndihmën dhe përparësitë e garantuara me ligj për femrën, fëmijën dhe familjen.
- 1.3. institucionet dhe organizmat që mund t'i ofrojnë nënës, fëmijës dhe familjes mbështetje morale dhe sociale.
- 1.4. institucionet shëndetësore që kryejnë ndërprerjen e shtatzënisë në kushte të sigurta mjekësore.

## **Neni 9**

Ndërprerja e shtatzënisë bëhet vetëm në institucionet shëndetësore nga mjekët specialist obstetër-gjinekolog të licencuar.

## **Neni 10**

Në rast se femra edhe pas këshillimit dhe vizitës mjekësore, përsëritë vullnetin e saj për ndërprerjen elektive të shtatzënisë kërkohet konfirmimi i kërkesës së saj konform nenit 10.5 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor.

## **Neni 11**

1. Pas kërkesës me shkrim, mjeku gjinekolog-obstetër cakton terminin për ndërhyrjen mjekësore.
2. Termi për ndërprerjen e shtatzënisë caktohet së paku dy ditë pas vizitës së parë.

## **Neni 12**

1. Ndërhyrja mjekësore për ndërprerjen e shtatzënisë bëhet vetëm në kushte të sigurta mjekësore, që përcaktohen me akt nënligjor.
2. Çdo institucion shëndetësor i cili ofron shërbimet e ndërprerjes së shtatzënisë duhet të sigurojnë shërbim shëndetësor për trajtimin e ndërlikimeve të mundshme të ndërprerjes së shtatzënisë, që përcaktohen me akt nënligjor.

## **Neni 13**

1. Asnjë mjek nuk mund të detyrohet të kryejë ndërprerjen elektive të shtatzënisë kundër vullnetit të tij/saj.
2. Në rast se mjeku nuk pranon të kryej ndërprerjen elektive të shtatzënisë, institucionet shëndetësore publike dhe ato të përziera janë të obliguara të sigurojnë një zgjidhje të përshtatshme për femrën brenda të njëjtit institucion.

## **KREU IV**

### **RRETHANAT E VEÇANTA TË NDËRPRERJES SË SHTATZËNËSISË**

## **Neni 14**

Ndërprerja e shtatzënisë me motiv të përzgjedhjes se gjinisë së frytit është e ndaluar.

## **Neni 15**

1. Ndërprerja e shtatzënisë për arsye mjekësore në rastet ku konstatohet se vazhdimi i shtatzënisë, ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e femrës mund të bëhet në çdo periudhë të shtatzënisë, me vendimin e Komisionit mjekësor dhe pëlqimin e femrës shtatzëne përderisa ajo është e vetëdijshme.
2. Ndërprerja e shtatzënisë për arsye mjekësore kur vërtetohet se fetusit ka keq formime të papajtueshme me jetën, sëmundje ose gjendje të rënda që lënë invaliditet të rëndë dhe kanë trajtim të pasigurt, mund të bëhet në çdo kohë pas rekomandimit dhe vendimit të Komisionit mjekësor për ndërprerjen e shtatzënisë dhe pëlqimin e pacientes përderisa ajo është e vetëdijshme.
3. Indikacionet mjekësore për ndërprerjen e shtatzënisë për arsyet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni përcaktohen me akt nënligjor.

## **Neni 16**

1. Ndërprerja e shtatzënisë për arsye kriminologjike mund të behet gjer në javën e njëzetedytë (22) të shtatzënisë dhe lindja e indukuar edhe më vonë me rekomandim mjekësor dhe pas konfirmimit nga institucionet kompetente të cilat janë të autorizuara të përcaktojnë nëse shtatzënia është pasojë prej njëres nga veprat penale në vijim:

1.1. dhunimit;

1.2. marrëdhënieve të padëshiruara të femrave të cilat janë viktima të trafikimit dhe shfrytëzimit seksual të detyruar;

1.3. marrëdhënies seksuale me të mitur ose incestit.

## **Neni 17**

1. Përbërja e Komisionit mjekësor për ndërprerjen e shtatzënisë është e rregulluar me nenin 107 pika 3 të Ligjit për shëndetësi.

2. Komisioni mjekësor për ndërprerjen e shtatzënisë ka të drejtë që të kërkojë ndihmë dhe këshillë profesionale nga ekspertë të lëmive të ndryshme, në bazë të vlerësimit të anëtarëve të tij.

## **KREU V**

### **FAZA PAS NDËRPRERJES SË SHTATZËNËSISË**

## **Neni 18**

Pas ndërprerjes së shtatzënisë, në të gjitha rastet, mjeku apo ekipi mjekësor që ofron këtë shërbim shëndetësor është i detyruar që të informojë femrën për shërbimet e planifikimit familjar dhe ta këshillojë atë për metodat dhe mjetet kontraceptive që ofron ai ose institucionet tjera shëndetësore.

## **Neni 19**

Institucionet shëndetësore të të gjitha niveleve ofrojnë shërbime të planifikimit familjar për burra dhe femra si mënyrë për ushtrimin e plotë të drejtave të tyre të vendimit për madhësinë e familjeve të tyre dhe intervale të lindjeve, si dhe shmangien e shtatzënësive të padëshiruara.

## **KREU VI**

### **DISPOZITAT E VEÇANTA**

#### **Neni 20**

Ndalohet çdo lloj promovimi dhe reklamimi, direkt ose indirekt, me fjalë ose figurë, i institucioneve, metodave, medikamenteve e produkteve që shkaktojnë ndërprerje të shtatzënisë, përveç se në botimet shkencore të destinuara për mjekë dhe farmacistë.

#### **Neni 21**

Çdo institucion shëndetësor është i obliguar të raportoj të dhënat statistikore lidhur me ndërprerjen e shtatzënisë.

#### **Neni 22**

Bashkëpagesa për ndërprerjen elektive të shtatzënisë në institucionet shëndetësore rregullohet me akt nënligjor.

## **KREU VII**

### **DISPOZITAT DISIPLINORE DHE NDËSHKIMORE**

#### **Neni 23**

Në rastet e mos zbatimit dhe shkeljeve të dispozitave të këtij ligji do të merren masa konform neneve 118, 119 dhe 120 të Ligjit për Shëndetësi dhe nenit 152 të Kodit Penal të Kosovës.

## **KREU VIII**

### **DISPOZITAT KALIMTARE**

#### **Neni 24**

Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministria e Shëndetësisë do të nxjerr akte nënligjore të përcaktuara me këtë Ligj në afat prej një (1) viti.

#### **Neni 25**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-110**  
**6 nëntor 2008**

**Shpallur më Vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03-V-081, datë 22 janar 2009.**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**